



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2023:007182

Datë: 26.01.2023

Numri i dokumentit: 03908322

P.nr.18/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË -Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtarja e vetme gjykuese Benita Berisha, procesmbajtësen-praktikanten Diellza Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurit G. H. nga M. për shkak të veprës penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.2304/22 të dt.10.01.2023 dhe kërkesës për dhënien e urdhërit ndëshkimor, pa mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, jashtë seancës, me datë 26.01.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.2304/22 të dt.10.01.2023, andaj gjykata konform dispozitës të nenit 495 të KPPK-së, jep:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

G. H. nga i ati R. e ëma M. i lindur më ... në M. me vendbanim në rr.“D.” nr. .. M. ... me numër personal ..., i martuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: prej datës së pavërtetuar e deri me datë 21.04.2022 në M. në njësinë elektrik me numër 39258271, i pandehuri me anë të lajthimit, largimit ose në mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmangies së pagesës për shërbime të tilla ashtu që i njëjti ka bërë ndërhyrje të paautorizuar në rrjetin elektrik duke u kyçur direkt në rrjetin elektrik në atë mënyrë që ka këputur kabullin e daljes i cili hynë në njësinë elektrik, te cilin e ka kyçur direkt në kablo të furnizimit para njësitit duke furnizuar tërë objektin jashtë njësitit, me çka në këtë rast i pandehuri i ka shkaktuar dëm të dëmtuarës-kompanisë KEDS në shumë prej 471.55 €.

-Me këtë ka kryer veprën penale: Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4 ,7 ,8, 17, 38, 39, 40, 43, 69, dhe nenit 314 të KPRK-së, si dhe bazuar në nenet 365, 450, 450, 463, 493, dhe 495 të KPPK-së, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I.** Në shumë prej **200 €** (dyqind Euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi. Në rast se i pandehuri nuk e paguan gjobën në afatin e caktuar, atëherë gjykata do të veprojë konform nenit 43 par.3 të KPRK-së , ndaj të njëjtit dënim me gjobë do t'i zëvendësohet me dënim me burgim duke i llogaritur për çdo 20 € (njëzet) euro gjobë me 1 (një) ditë burg.
- II.** OBLIGOHET i pandehuri që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € dhe në emër të Fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.
- III.** Pala e dëmtuar KEDS, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko-civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.2304/22 të dt.10.01.2023, kundër të pandehurit G. H. për shkak të veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të KPRK-së. dhe njëherësh, nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor- Dënim me gjobë, me arsyetimin se ka prova të besueshme nga kallëzimi penal dhe provat e propozuara lidhur me arsyeshmërinë e aktakuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve se i pandehuri, vërtetë e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjykata, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, gjeti se aktakuza dhe kërkesa janë të bazuara dhe se janë plotësuar kushtet nga neni 493 i KPPK-së, që të pranohet kërkesa për dhënien e urdhrin ndëshkimor dhe në përputhje me nenin 495 të KPPK-së të jepet aktgjykimi pa u mbajtur shqyrtimi gjyqësorë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që në shkresat e lëndës ka prova të mjaftueshme në bazë të të cilave vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës si: procesverbali me nr.2018698, i datës 21.04.2022, Fatura nr. .DMIHP. e datës 13.05.2022, foto dokumentacioni me gjithsej katër (4) fotografi, fatura DMIHP ... e dt.13.05.2022, dhe shkresat e tjera të lëndës, të gjitha këto janë prova të besueshme me të cilat vërtetohet se i pandehuri e ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë.

Andaj gjykata duke u bazuar në këto prova të besueshme vërtetoi se në veprimet e të pandehurit ekzistojnë elementet e veprës penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), për këtë edhe i shqiptoi urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me dispozitat ligjore të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, për veprën penale Vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.1, me të cilën akuzohet i pandehuri, ligjvënësi ka parashikuar dënimin me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet, që nënkupton se në rastin konkret zbatohen dispozitat ligjore të procedurës së veçantë nga neni 495 të Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës.

Me rastin e caktimit të lartësisë së dënimit gjobë, konform nenit 69 të KPRK-së, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit. Gjkata çmon se dënimi i shqiptuar është dënim i drejtë dhe i ligjshëm dhe është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale meqë rast vepra penale është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur në këtë çështje penale.

Andaj, gjykata vlerësoi se edhe me këtë dënim të shqiptuar do të arrihet qëllimi i dënimit në vështirësi me nenin 38 të KPRK-së, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie në kundërshtim me ligjin, pasi që gjykata mundet të ashpërsojë dënimin kundër tij, si dhe me këtë dënim shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale të kryer dhe ngrit moralin dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Po ashtu ky dënim do të shërbejë edhe si preventivë që në të ardhmen i pandehuri të ketë kujdes të shtuar që të mos bie më në kundërshtim me ligjin.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, për paushallin gjyqësor, u mor në kuptim nenit 450 par.2 nën paragrafi 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPK-së. Ndërsa taksa për kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 nën par 3.1 të Ligjit nr. 05\L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest të rregullt juridiko-civil, gjykata e mori në bazë të nenit 463 par .2 lidhur me par.1 të KPPK-së.

Nga se u tha më lartë, në kuptim të neneve 365 dhe 495 të KPPK-së u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.18/2023, të datës 26.01.2023

Procesmbajtëse-Praktikante:
Diellza Bojku

G J Y Q T A R J A
Benita Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi, i pandehuri apo mbrojtësi i tij mund të paraqesin kundërshtim në afatin prej 8 ditësh, nga dita e pranimit të tij, në këtë gjykatë.